

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Kultura muzikore* për vitin I (e parë) në arsimin e mesëm profesional për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore Kultura muzikore për vitin I (e parë) në arsimin e mesëm profesional bazohet në qëllimet /rezultatet e parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet rregullisht në bazë të planit mësimor të caktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, megjithatë duhet të ruhet fondi javor i orëve të parapara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndë mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë mësimore në programin e shkurtuar në kohëzgjatje prej 35 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin mësimor të rregullt.

2. Pasqyra e temave dhe përmbajtjet mësimore

Tema/Fusha

Muzika gjatë historisë (24 orë)

Njësitë mësimore:

1. Vendi dhe roli i muzikës në shoqëri
2. Muzika e Renesancës (format muzikore dhe instrumentet)
3. Përfaqësues të muzikës së Renesancës (me dëgjimin e muzikës nga kompozitorët e dhënë)
4. Baroku në muzikë (format muzikore dhe instrumentet e barokut)
5. Përfaqësuesit e barokut muzikor .J. S. Bah dhe G. F. Hendli (me dëgjimin e muzikës nga kompozitorët e dhënë)
6. Klasicizmi (në përgjithësi) – klasikizmi muzikor, simfonia,opera
7. Përfaqësuesit e klasikizmit – Hajdn, Mocarti, Betoveni
8. Operat e V. A. Mocart (rëndësia e V. A. Mocart për operën)
9. Krijimtaria simfonike e L.V. Betoven (rëndësia e simfonive të Betovenit në artin muzikor)
10. Romantizmi (në përgjithësi) – romantizmi muzikor (këngë solo, poema simfonike, koncerti, baleti)
11. Përfaqësuesit e romantizmit muzikor (Shubert, Smetana, Çajkovski)
12. Petar Iliç Çajkovski – ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Çajkovskit
13. Opera e romantizmit dhe përfaqësuesit e saj (Verdi, Rosini, Wagner, Bize)
14. Impresionizmi muzikor – arabeska, bolero
15. Përfaqësuesit e impresionizmit muzikor (Debisi, Ravel)
16. Muzika në shekullin XX – karakteristikat- kantata skenike
17. Përfaqësuesit e muzikës në shekullin XX – Igor Stravinski dhe Karl Orf
18. Veprimtarët e parë muzikor nga Maqedonia (Jovan-Jan-Kukuzel, Atanas Badev, Naum Milladinov)

19. Muzika në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI (muzika korale, opera, baleti)
20. Përfaqësuesit e muzikës në Maqedoni në shekullin XX dhe XXI (Skalovski, K. Makedonski, Prokopiev, Lumani, Tairi)
21. Zhanret dhe instrumentet popullore në shekullin XX dhe XXI
22. Elementet etno në zhanret popullore
23. Muzika dhe teknologjia – multimedia
24. Interpretuesit e njohur të muzikës popullore (duke dëgjuar shembuj të muzikës)

II Tema /Fusha

Tradita muzikore dhe doket (12 orë)

Njësitë mësimore

1. Karakteristikat themelore të traditës dhe zakoneve muzikore në RMV
2. Aktivitetet projektuese: Hulumtojmë për traditën dhe doket muzikore të popujve në RMV
3. Vlera dhe rëndësia e muzikës tradicionale dhe doket
4. Ngjashmëritë dhe dallimet në muzikën tradicionale të popujve në RMV dhe përfaqësimin e saj në muzikën artistike
5. Kënga popullore (origjinale, qyteti i vjetër, i sapo krijuar, traditë publike-rurale dhe urbane)
6. Përpunimi i një kënge popullore nga nxënësit
7. Instrumentet popullore dhe ndarja e tyre
8. Instrumentet popullore frymore
9. Instrumentet popullore me goditje

10. Instrumentet popullore me tela
11. Tradita popullore e valleve
12. Ngjashmëritë dhe dallimet në traditën e valleve të popujt në RMV

3. Rekomandimet didaktike

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore Kultura muzikore për vitin I (e parë) në arsimin e mesëm profesional do të realizohet për 159 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 32 orë mësimore me kohëzgjatje prej 35 minuta. Përmbajtjet mësimore mundësojnë integrimin e brendshëm dhe të jashtëm e cila nënkupton planifikimin integruar ndërmjet temave mësimore në kuadër të programit të arsimit muzikor, si dhe planifikimin dhe integrimin e jashtëm me lëndët tjera mësimore. Përmbajtjet mësimore nga programi mbeten të njëjta por të radhitura në kuadër të 32 orëve mësimore, ku edhe është bërë shkurtimi prej 4 orë.

Për realizimin e përgjithshëm të përmbajtjeve mësimore të temave mësimore në këtë program është paraparë shkurtimi, përkatësisht integrimi i përmbajtjeve mësimore prej 4 orë mësimore, të bëhet ndërmjet dy temave. Shkurtimi konkret i programit parashikohet në këtë mënyrë: - njësia mësimore me numër 20 nga tema e parë integrohet me njësinë mësimore numër 4 nga tema e dytë; - njësia mësimore numër 22 nga tema e parë integrohet me njësinë mësimore numër 3 nga tema e dytë; - njësia mësimore numër 23 nga tema e parë integrohet me njësinë mësimore numër 2 nga tema e dytë; - njësia mësimore numër 24 nga tema e parë integrohet me njësinë mësimore numër gjashtë nga tema e dytë. Mundet edhe integrimi i njësive mësimore të ndryshme nga të theksuarat, në qoftë se nga përvoja pedagogjike e mësimdhënësit disa përmbajtje të caktuara janë treguar si të qëlluara për ndërlidhje reciproke.

Rekomandohet mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore në të cilën ka të integruar dy përmbajtje mësimore të ketë kujdes në vëllimin e materies mësimore gjatë planifikimit dhe përzgjedhjes të aktiviteteve dhe teknikave më efektive, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e orës mësimore. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e caktuara në programin mësimor të rregullt. Ndjekjen e të arriturave të nxënësve secili mësimdhënësi individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të prashikuara për realizim duke përdorë metodat, teknikat dhe instrumente të ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në bazë të normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore Kultura muzikore për vitin I (e parë) në arsimin e mesëm profesional e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
